

BARDHYL DEMIRAJ

MJETE GJUHËSORE NË VEPRËN SHKENCORE TË PROF. EQREM ÇABEJT

Me veprën e tij shkencore prof. Eqrem Çabej ka dhënë një ndihmesë të çmuar përlëvrimin dhe pasurimin e gjuhës sonë të përbashkët letrare kombëtare. Në këtë ndihmesë përfshihet jo vetëm shtjellimi në planin teorik dhe praktik i problemeve të ndryshme që ka nxjerrë zhvillimi i gjuhës letrare shqipe në epokën e socializmit¹, por edhe vetë gjuha e veprës së tij, e cila ka luajtur rol të drejtpërdrejtë në kristalizimin e stilit të ri shkencor — teknik dhe të

1) Shih më hollësishët përkëtë pamje të veprimtarisë së prof. E. Çabejt artikujt e botuar në revistën «Studime filologjike», 1988, 3, sidomos referatin «Vepra e prof. E. Çabejt në fushën e shkencës e të kulturës shqiptare», të A. Kostallarit e S. Mansakut, dhe artikujt: *Reth shtresimit historik të leksikut të shqipes sipas studimeve të prof. E. Çabejt, të J. Thonait; Kontributi i prof. E. Çabejt për pastërtinë e gjuhës shqipe dhe pasurimin e saj me fjalë-terma*, të F. Lekës.

ligjërimit libror në përgjithësi, sidomos në lëmin e gjuhësisë. Disa mjete gjuhësore që karakterizojnë trashëgiminë shkencore të prof. E. Çabejt, në një mënyrë a në një tjetër i ndihmojnë brezat e rindët studiuesve për të përvetësuar më mirë gjuhën letrare shqipe, larminë e stileve të saj funksionale.

Duke u marrë me problemet themelore të historisë së gjuhës shqipe, prof. E. Çabej ka zbuluar edhe prirjet e përgjithshme të zhvillimit të saj. Ato do të ndikojnë gjerësisht në shkrimet e tij shkencore, ku do të jetë kurdoherë e pranishme ndjenja e perspektivës historike të gjuhës amtare. Ai shkruan duke mbajtur gjithmonë parasysh tiparet më të theksuara dhe të qëndrueshme të kësaj gjuhe. Në çdo fjalë dhe rresht ndihet dora e kujdeshme e gjuhëtarit dhe e filologut të mirëfilltë që qëmton me kujdes në thesaret e shqipes, duke përzgjedhur nga gjithë pasuria e mjeteve të shprehjes atë që është më e përshtatshme përfushë e veprimtarisë, përfshirë kohën kur shkruan, përfshirë qëllimin që do të arrijë.

Fusha e veprimtarisë që ndërmerr, së bashku me përfundimet që arrin prof. Eqrem Çabej, nuk i interesojnë vetëm një rrëthi të ngushtë specialistësh. Duket që dijetarin e shqetëson çdo çast mendimi se gjithë bashkëkombasit kërkojnë të njojin etnogenezën e kombit të vet, të mësojnë gjithçka rrëth historisë dhe parahistorisë së popullit shqiptar, rrëth gjuhës dhe emrit kombëtar që ai mbart. E kjo do t'u përçohej atyre nëpërmjet një gjuhe shkencore, larg nga polemika retorike e pafund. Në veprën e prof. E. Çabejt puna dhe përfundimet bindëse përfshirë çështjet e mëdha të gjuhës shqipe sendëzohen nëpërmjet një gjuhe të thjeshtë, të kthjellët e të rrjedhshme, e cila e ngushton mjaft largësinë nga gjuha popullore.

Larmia e mjeteve gjuhësore në krijimtarinë e tij vërehet në disa drejtime, si në leksik dhe në terminologji, në frazeologji dhe mënyra shprehjeje, e, së fundi, në përdorimin e disa arkaizmave gjuhësorë.

Pa dyshim, prof. E. Çabej është një nga njoħesit më të thelluar të shqipes. Puna e tij themelore si etimolog dhe historian i gjuhës shqipe bëri që ai të hulumtonte një numër të pafund njësish leksiko-semantike të panjohura ose pak të njoħura, të rralla ose të harruara. Duke i kaluar nëpér sitën e tij, ai dallon atë që është rrënje nje shqipe nga ajo që është e huazuar. Gjithashtu

ai kérkon të paraqesë një shtresim kohësor të huazimeve, duke vëzhguar me syrin e specialistit se çfarë ka hyrë tashmë në thesarit leksikor të shqipes, çfarë ka mbetur si mish i huaj për të dhe çfarë përdoret ose mund të përdoret edhe sot me cilësinë e ndërkomëtarizmave.

Një pjesë të mirë të fjalëve të rralla, të mbledhura nga goja e popullit, së bashku me fjalë të tjera të zakonshme të ligjëritimit bisedor dhe libror, prof. E. Çabej i përzgjedh me kujdes, me synimin që nëpërmjet tyre të mënjanjojë fjalët e huaja të panevojshme. Të tilla fjalë janë, p.sh.: *përbyllje* «konkluzion», *qenësor* «esencial», *i përaférishém* «aproksimativ», *shkërbim* «imitim», *ndikim* «influencë», *mjedis* «ambient», *parapëlqeji* «preferoj», *send*, *gjë* «problem», *rrënjas*, *anas* «autokton», *paravendoj* «supozoj», *përmendore* «monument», *shpërnjoh* «mohoj».

Autori zotëron dhe përdor me mjeshtéri njësi leksikore pak të njobura për gjuhën letrare, por që janë të gjalla në popull dhe shpesh mbartin ngjyrime stilistike të vecanta, si: *anadetas* «banor në brigjet e detit», *tejdet* «vend përtëj detit», *enë (lundrimi)* «anijs», *gjëllij* «jetoj», *ravë* «gjurmë», *farkoj* «krijoj», *hulli* «vijë», *almise* «vegël», *qerthull* «rreth», *i ryeshëm* «me traditë», *i pavdire* «i pavdekshëm». Nuk mungojnë edhe raste kur autori lenton vetë fjalë të reja ose kalke (leksikore e semantike), siç janë p.sh., fjalë të përbëra e të përngjitura: *largshikues*, *largshkues*, (gjë) *e pakurri-njërendësie* etj.; fjalë të prejardhura si, ndajfolje me -*isht*: *lashtësisht*, *alfabetisht*, *nevojisht*, sipas *detyrimisht*, *shkencërisht*, *origjinalisht* etj.; mbiemra me -*or*: *vullnetor* «voluntativ», *kohësor* «kronologjik», *pjesor* «parcial» ose emri *visore* «peisazh».

Përpjekja e vetëdijshme e prof. E. Çabejt për të futur në ligjërimin libror fjalë të gurrës populllore, si edhe për të krijuar në raste të nevojshme edhe njësi të reja leksikore është bërë kurdoherë me synimin që mendimet të shprehen me qartësi e përpikëri të madhe e në të njëjtën kohë të janë të kuptueshme e të përvetësueshme nga lexuesit e thjeshtë. Ai ecën kështu në hullinë e lëvruesve të shquar të gjuhës së bukur shqipe, si: N. Veqilharxhi, K. Kristoforidhi, N. Frashëri, S. Frashëri, A. Xhuvani etj.

I njëjti synim përshtkon edhe punën e prof. E. Çabejt me shtresën e leksikut të ngushtë profesional, në të cilën vendin kryesor e zë terminologjia gjuhësore. Në çdo hap ndihet përpjekja e tij për

të zëvendësuar terminologjinë e huaj gjuhësore e, në ndonjë rast, edhe atë me karakter të përgjithshëm me fjalë nga brumi i shqipes¹. Për këtë qëllim ai shfrytëzon, në radhë të parë, trashëgiminë shkencore të pararendësve dhe të bashkëkohësve të tij. Të tilla janë fjalët-terma: *shtresë*, *nën(mbi)shtresë* «strat, sub (super) strat», *gjedhe* (fjalëformuese) «model», *risi* «inovacion», *rrjedhojë*, *prejardhje* «derivat», *bigëzim*, *dysi* (dialektore), (gjuhë) *marrëse*, *dhënëse*; *balli* (i fjalës) etj. Por nuk mungojnë edhe rastet kur ai vetë shndërron në terma fjalë të gjalla dhe jetëgjata të gurrës popullore. Përmendim këtu, ndër të tjera: *pjesore* «konkordanca parciiale», *fugë* (fjalësh) «varg», *i zbartë* «i desemantizuar», *mis* (gjuhësor) «familje», *e ardhme vullnetore* «futurum voluntatum», *lidhje birërie* «relacione filiacioni», *kohësor* «kronologjik» etj. Një terminologjie me karakter më të përgjithshëm i takojnë fjalët: *dukuri* «fenomen», *cak* «term», *rrymë* «current», *ble* «vêllim», *lentim* «krijim», *lëndë* «material», *send* «çështje, problem», *thurimë* (gërshetim i veprimit të një drame», *gojkë* «deltë», *harrje* «shosshitje kritike», *kodërvorre* «tuma» etj.

Vepra e prof. E. Çabejt është e pasur edhe në frazeologji e në fjalë a togje fjalësh me vlerë shprehëse. Ato ia shtojnë edhe më shumë ngjyresën popullore gjuhës së dijetarit, duke e bërë atë më tërheqëse. Përmendim këtu disa prej tyre, si: *vise-vise*, (sot) më se *kurrë*, *bukur i madh*, *ka rasa*, në *krye* të *herës*, (gjë) *gand* dhe e *rastit*, *kryekrejet*, në *burimë* (e fjalëve), *përderdh shënime*, *mish* dhe *asht* (i gjuhës), ia *dal mbanë* etj.

Karakteristikë e gjuhës së tij është edhe larmia e fjalëve dhe e togjeve të fjalëve të ndërmjetme, për të treguar shkallën e vërtetësisë së kumtimit: *pas gjase*, *pas gjithë gjasash*, *pakmos*, *afërmendësh*, *mbase*, *ngase*, *kinse* etj.; vlerësimin emocionues të kumtimit: *çuditërisht*, *mjerisht*, *fatmirësisht*; burimin e kumtimit: *sipas tij*, *sipas hullisë së*, etj.; qëndrimin ndaj mënyrës së formulimit të kumtimit: *me një fjalë*, *shkurt*, *me fjalë* të *tjera*, *siç del*, *nga sa u tha* etj. Të gjitha këto janë të nevojshme gjatë hartimit të një studimi shkencor.

Vlerë gjuhësore shprehëse të veçantë marrin sidomos ndërtimet e fjalive me folje modale (*mund*, *duhet*, *do*, *mbetet*, *kam*), që

1) Kjo përpjekje vërehet sidomos në vitet e fundit të krijimtarisë së tij shkencore. Shih më hollësisht për këtë: F. Leka, *artikull i përmendor*.

shërbijnë për të paraqitur veprimin e shprehur nga folje ndjekëse si të mundshëm ose të lejueshëm, të detyrueshëm ose të domosdoshëm: *mund të qëmtohen, mund të vërehet; duhet kuptuar historikisht; nuk duhet të jetë një gjë gand dhe e rastit; duan sqaruar; duan pasur parasysh, mbetet për të hetuar, ka për të parë etj.* Në shkrimet e tij ndeshet në shumë raste edhe folja *duket*, e përdorur me vlerë modale: *duket të ketë banuar, duket të kenë qënë* etj. Në këta shembuj ajo shpreh më fort *hamendje, dyshim*. Përdorimi i këtij tipi fjalësh dëshmon qartë qëndrimin e matur dhe të përpiktë të dijetarit ndaj asaj që kumton, çka e kushtëzon vetë fusha e veprimtarisë, e cila është e mbuluar nga errësira e periudhave të hershme historike e parahistorike të gjuhës.

E larmishme paraqitet gjuha e veprës së prof. E. Çabejt dhe në mjetet sintaksore që përdor. Llojet e fjalive dhe të ligjëratave gërshtohen aty në harmoni të plotë dhe nuk e pengojnë aspak rrjedhën e gjykimit. Gjuhën e tij e karakterizon ligjérata e zhrejtë, shumë herë e gjatë, me fjali të përbëra me nënrenditje e pa lidhëza.

Përdorimi i arkaizmave gjuhësorë zë një vend të veçantë në krijuimtarinë shkencore të prof. E. Çabejt, sidomos në shkrimet e tij të para. Hulumtimi i gjuhës së autorëve tanë të vjetër dhe i dialekteve të shqipes, së bashku me të folmet e diasporës arbëreshe, nuk mund të mos linte gjurmë në strukturën gjuhësore të shkrimeve të tij. Ai është i vetëdijshëm për vështirësitë objektive të punës që ndërmerr e të fushës së veprimtarisë ku hulumton. Kjo bën që gjuha e tij, herë-herë, të luajë rolin e ndërmjetësit kohësor midis fazës së sotme të zhvillimit të gjuhës, e cila gjëllin e freskët te lexuesi i thjeshtë, dhe fazës më të vjetër të saj, që ruhet e dokumentuar tek autorët tanë më të vjetër (Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi etj.), si edhe në disa të folme dialektore ruajtëse. Përdorimi i arkaizmave në veprën e tij merr në këtë mënyrë ngjyresa të veçanta. Të tilla arkaizma i ndeshim kudo, në fjalor, në disa forma fjalësh, si edhe në disa ndërtimë sintaksore. Kështu p.sh., ndeshim tek ai fjalë dhe trajta fjalësh, si: *rasë* (për rast), *kuzinë* (për *kuzhinë*); *periodë* (për *periudhë*); *të folët* (për të folurit); *i posaçmë* (për *i posaçëm*); *sajime të ra* (për të reja); *veçanësi* (për *veçori*); *gjindet* (për *gjendet*) etj.; mbiemra pa fundoren -të, si: *i afër, i shumë, i pakë, i largë*; në sistemin foljor

ndeshim raste të ndërtimit të diatezave pësore-vetvetore në ko-
hët e përbëra me foljen *kam*: *u ka ushtruar*, *u pat ushtruar*, *u ka formuar*, *u kishte kryer* etj. Në fushën e sintaksës afrimi me gjuhën e autorëve të vjetër duket, ndër të tjera, në vendosjen e përemrave të pacaktuar *i tillë*, *tjetër*, të rreshtorëve dhe të mbi-
emrave të shkallës sipërore, të cilët i gjejmë rregullisht (e jo
vetëm pér arsyen shprehëse) para emrit që përcaktojnë: ...
tjerat treva; në të tjerat *pjesë* të *ligjërata*; *do* të më *jepet rasti tjetër herë*; *e tillë rrugë zhvillimi*; *ka lënë më* të *thellat gjurmë*; *ky më i madhi burrë i historisë shqiptare*; *do* të *gjejmë më* të *moçmen shtresë* etj. Me të folmet e ndryshme dialektore dhe të diasporës arbëreshe afrohen ndërtimet *emër* + *përcaktor* + *përcaktor* (*mbiemër*), ndër të cilët përcaktori i dytë del i emërzuar
në trajtë të shquar me funksion ndajshimi: *o-ja indoevropiane e shkurtra*; ...
në disa ligjërimë e në fazat e saj të *përparmet*; ...
në pjesën më të madhe të *tyren*; ...
në atdheun e tyre të *sotmin*; *emri nacional i vjetri*; ...
gjendja gjuhësore e brendshmjë etj.

Zhvillimi i vrullshëm që mori gjuha letrare kombëtare në dhjetëvjeçarët e fundit, së bashku me përvijimin e stileve të ndryshme funksionale, e rrudhi mjaft përdorimin e arkaizmave. Prej tyre hoqi dorë më vonë me vetëdije edhe prof. E. Çabej.

Gjuha e veprës së prof. E. Çabejt përfaqëson modelin e marrëdhënieve që duhet të vendosen ndërmjet lexuesit, dijetarit dhe fushës së veprimtarisë ku ai punon. Ajo ndihmon pér të njohur më mirë mundësitë shprehëse të shqipes e, njëkohësisht, pér të ruajtur pastërtinë e saj në shkrimet shkencore, duke ndikuar drejt-përdrejt në zhvillimin e kulturës gjuhësore të studiuesve të rinj.